

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryeprokurorja e Speciales përshëndet aktgjykimin: UÇK-ja dhe lufta për pavarësi nuk ishin objekt i ndje kjes penale
ADRESA	https://albeu.com/kosove/kryeprokurorja-e-speciales-pershendet-aktgjykimin-uck-ja-dhe-lufta-per-pavaresi-nuk-ishin-objekt-i-ndjekjes-penale/1014574/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 14:16:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 14:15:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bcf2b947a78de106956ef389d2af0c5a5fdaa673b4baf5c05dc373a3c50c09a4
TEKSTI	4221b5c7087d9c2bf0f86eb89b1429310465f69ba2d7728576e4a00f22bde0a4
PAMJA	a6e296df74f3bb95edf84ca251402a1c66a6837564c9e053a6383c71a052665a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9867fd69536f559fe597478ca7a6319806c1698a1a63fd67b522d21c620cd290
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9867fd69536f559fe597478ca7a6319806c1698a1a63fd67b522d21c620cd290>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryeprokurorja e Speciales përshëndet aktgjykimin: UÇK-ja dhe lufta për pavarësi nuk ishin objekt i ndjekjes penale



Prokurorja e Specializuar Kimberly West e ka cilësuar aktgjykimin e shpallur sot ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit si një vendim me rëndësi për sundimin e ligjit në Kosovë dhe për drejtësinë e vonuar ndaj viktimave.

Gjykata vendosi se të katër të akuzuarit kanë përgjegjësi penale individuale për krimet e luftës që lidhen me arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme.

Sipas vendimit, Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 vjet, Rexhep Selimi me 13 vjet, ndërsa Jakup Krasniqi me 25 vjet.

"Aktgjykimi i sotëm, i mbështetur vetëm në fakte dhe në ligj, përbën një hap të rëndësishëm drejt përgjegjësisë dhe forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë", deklaroi Prokurorja e Specializuar. Ajo shtoi se gjykata ka vërtetuar se asnjë person, pavarësisht pozitës apo autoritetit politik, nuk qëndron mbi ligjin dhe nuk gëzon imunitet përballë përgjegjësisë për krime të rënda ndërkombëtare.

Kimberly West nënvizoi se çështja e ngritur nga ZPS-ja kishte në qendër përgjegjësinë penale të individëve dhe nuk synonte të vinte në pikëpyetje ndonjë narrativë historike.

"Në përputhje me mandatin e saj, ZPS-ja ka kërkuar të mbajë përgjegjësi individët për veprimet e tyre, asgjë më shumë", tha më tej Znj. Uest. "ZPS-ja nuk ka ndjekur penalisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe as luftën e zhvilluar për pavarësinë e Kosovës."

"Persona të caktuar i shfrytëzuan rrethanat e luftës për të kryer krime të rënda, ndaj është në të mirë të Kosovës që ata tani të përballen me përgjegjësinë", vijoi ajo.

të fundit /



Kryeprokurorja e Speciales përshëndet aktgjykimin: UÇK-ja...



Reagim i ashpër i Spiropalit pas vendimit të Hagës për...



Vendimi për ish-udhëheqësit e UÇK-së: Detaje mbi fajësinë d...



SHBA-ja u kërkon palëve të pranojnë aktgjykimin ndaj ish-...



Kategoria e Parë zbrit në fushë me 6 ndeshje, ja rezultatet LIVE të...



Arsenali vijon ndjekjen e yllit të Real Madridit, bisedimet në...



Afrim Gashi: Vendimi ndaj ish-drejtuesve të UÇK-së nuk e mbyll...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Gjatë paraqitjes së çështjes së saj, ZPS-ja solli në sallën e gjyqit 125 dëshmitarë, të cilët dëshmuuan drejtpërdrejt, si dhe dorëzoi rreth 3 000 prova materiale në shumë gjuhë.


Në aktgjykim, trupi gjykses arriti në përfundimin se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi ishin fajtorë për arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar të të paktën 385 personave, për trajtim mizor ndaj të paktën 49 personave, për torturë ndaj 303 personave dhe për vrasje të paligjshme të të paktën 96 personave.

Veprat penale prekën qindra civilë dhe persona që nuk merrnin pjesë në luftime. Ato u kryen nga prilli i vitit 1998 deri më 20 qershor të vitit 1999, në komuna të ndryshme të Kosovës dhe në dy rrethe të Shqipërisë veriore.

Prokurorja e Specializuar bëri të ditur gjithashtu se Zyra e ZPS-së do ta analizojë me kujdes të gjithë aktgjykimin gjatë ditëve në vijim, duke përfshirë edhe gjashtë pikat e aktakuzës për krime kundër njerëzimit, për të cilat nuk pati dënime.

Shtuar më 16.09.2026 16:15

Tags: [Prokurorja e Specializuar Kimberly West](#), [uck](#), [vendimi](#)



Daçiç: Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së përforcon qëndrimin e...



Vendimi për ish-udhëheqësit e UÇK-së: Detaje mbi fajësinë dhe...



SHBA-ja u kërkon palëve të pranojnë aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së



Përparim Rama: Vendimi është i padrejtë, përpjekja për drejtësi vazhdon



Kurti pas vendimit në Hagë: Gjenocidi u krye nga Serbia, dënimi i krerëve t...



Ambasada e Kosovës në Hagë u bën apel qytetarëve të ruajnë qetësinë



Charles Smith, gjyqtari amerikan që i dënoi me 81 vjet burg katër ish-krerët ...



Sela pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së: Ata mbrojtën jetën dhe i dhan...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com